



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ .2023

VENDIM

Nr. 116, datë 13.03.2023

PËR

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE
TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU
USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; Të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: Nenet 278/3/6 dhe 300/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Ermelinda Fejzo, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Akuza: Nenet 76-25, 139-25, 279 dhe 297 të Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Ermelinda Fejzo, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; Të pandehur: {...}, {...}, {...} dhe {...}; Akuza: Nenet 283/2, 279, 197 dhe 198 të Kodit Penal.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Alma Kolgjoka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Akuza: Neni 100/2 dhe 130/a të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Xhevdet Lika dhe Ardit Kuka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Përmbushje detyrimi kontraktor.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Luljeta Kole, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me Kërkues; Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit” e kryer në bashkëpunim-neni 283/3 i Kodit Penal dhe “Mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik”-neni 242 i Kodit Penal.

2. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gentiana Shukullari dhe Luljeta Kole, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; Të pandehur: {...}, etj; Akuza: “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e kryer në bashkëpunim-neni 283/2 i Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gentiana Shukullari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: Heqje e zotësisë juridike për të vepruar.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Ersida Bajgora, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, çështjen civile me Paditës: {...} dhe {...}; I paditur: {...}; Objekt: Shpërblim dëmi.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Arben Dosti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen civile me Paditëse: {...}, {...} dhe {...}; I paditur: {...}; Objekti: Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: Përmbushje detyrimi.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet,

çështjen civile me Paditës: {...}, {...}, {...}, {...}; E paditur: {...}; Objekti: Detyrim për të paguar dëmin pasuror dhe jo pasuror.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Suela Dashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Paditëse: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet; Të paditur {...}, {...} etj; Persona të tretë {...}, {...}, etj; Objekti: Shpallje absolutisht të pavlefshme të veprimeve juridike.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Suela Dashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; I Pandehur: {...}; Akuza: “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive” – neni 280 i Kodit Penal; Objekti: Kërkesë për pushim dhe dërgim në gjyq.

6. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Arben Dosti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; I pandehur: {...}; Akuza: “Drejtim i automjetit në gjendje të parregullt” – neni 291 i Kodit Penal; Objekt: Kërkesë për kalim për miratimin e marrëveshjes së fajësisë.

7. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Suela Dashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I pandehur {...}; Akuza: “Vetgjuqësia” – neni 277 i Kodit Penal.

8. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Arben Dosti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; I pandehur: {...}; Akuza: “Drejtim i automjetit në gjendje të parregullt” – neni 291 i Kodit Penal; Objekt: Kërkesë për kalim për miratimin e marrëveshjes së fajësisë.

9. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; I pandehur: {...}; Akuza: “Kultivim i bimëve narkotike” – neni 284/1 i Kodit Penal; Objekt: Kërkesë për kalimin në gjyq.

10. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Arbana Selmanaj (relatore), Dorina Stroka dhe Mirela Mishgjoni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; I pandehur: {...}; Akuza: “Prodhim dhe shitja e lëndëve narkotike” dhe “Kultivim i bimëve narkotike” – nenet 283/2 dhe 284/1 i Kodit Penal; Objekt: Kërkesë për kalimin në gjyq.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Edison Tatoshaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, çështjen administrative me I paditur (Kundërpaditës): {...}; Paditës (I kundërpaditur): {...}, etj; I paditur në kundërpadi: {...}, etj; Objekti: Konstatim pavlefshmërie absolute të kontratës.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR